REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 867/20
Datë/Datum. 16.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.867/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "AC ing" Sh.p.k- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik "N.N.SH. EGO - ELSA ; AR-TECH SH.P.K"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Adaptimi i hapësirës për ANGIOGRAF" në kliniken e Neurologjisë- QKUK", me nr. të prokurimit: 701-20-5713-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Qendra Klinike Universitare e Kosovës, më datën: 13.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "AC ing" Sh.p.k- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Adaptimi i hapësirës për ANGIOGRAF në kliniken e Neurologjisë- QKUK", me nr. të prokurimit: 701-20-5713-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

II. ANULOHET, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Adaptimi i hapësirës për ANGIOGRAF në kliniken e Neurologjisë- QKUK", me nr. të prokurimit: 701-20-5713-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Qendra Klinike Universitare e Kosovës, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr.04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "AC ing" Sh.p.k- Prishtinë, aprovohet pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "AC ing" Sh.p.k- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 30.10.2020 me nr. 867/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Adaptimi i hapësirës për ANGIOGRAF në kliniken e Neurologjisë- QKUK", me nr. të prokurimit: 701-20-5713-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Qendra Klinike Universitare e Kosovës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59, 60, 64, 69, 72 si dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.11.2020, ka autorizuar eksperten shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 06.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit:

Eksperti Shqyrtues fillimisht sqaron, AK gjatë vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarim nga OE ankuesi sipas letrës standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, duke kërkuar sqarim lidhur me kërkesat e FDT-së:

Kërkesa e AK-së: Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Kriteri ka qene :

1. EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 EEC dhe OHSAS18001 & EN 1504-2;

1. Sqarimi -Te sjellet deshmia për EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 EEC; te ne është prezentuar vetëm shenja CE 93 42 EEC.

2. Sqarimi -Te sjellet deshmia OHSAS18001 me validitet; te ne ne sistem me datë validiteti është vetëm deri me 27.09.2020.

3. Sqarimi -Te sjellet deshmia EN 1504-2: te ne nuk është prezentuar fare.

OE ankuesi i është përgjigjur AK-së duke ia bashkangjitur dokumentet.

AK pasi ka pranuar dokumentet e prezantuara ka marr vendimin dhe ka eliminuar OE ankuesin me arsyetimin:

Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Prishtinë

" AC ing " SH.P.K. Qendra Tregtare Bregu i Diellit, Lok.Nr.47. -. PRISHTINË

Nr i Prokurimit	701-20-5713-5-2-1
Nr i brendshëm	701-20-274-521

Titulli: Adaptimi i hapsirës për ANGIOGRAF në klinikën e Neurologjisë - QKUK.

I/e nderuar(a)
Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit* Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Oferta e juaj nuk e plotson këto kritere:

Komisioni konstaton se Operatori ekonomik " AC ing " SH.P.K. Qendra Tregtare Bregu i Diellit, Lok.Nr.47. -. PRISHTINË nuk e ka përbushur kriterin :

1. **Nuk ka ofruar nuk ka ofruar certifikatat EN ISO 14971, OHSAS18001 dhe EN1504-2; edhe mbas kerkesës për sqarime nuk e ka plotsuar kët kritere – ka ofruar çertifikata qe nuk perkojnë me dokumentacionin e prodhuesit fillestar qe jan derzuar ne E Prokurimi.**
2. **OHSAS18001- jo me validitet**

Pretendimet e OE ankuesit janë:

Përgjigjja për piken e parë për certifikatën EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 ECC- ju kemi ngarkuar ne e-prokurimi ne pjese dorëzim ne AK-së me datë 15.10.2020 ne ora 14:57 me tekst te fajlit"100-MD103-022-1501-100-0_GMS.pdf " e cila i plotëson te gjitha si janë te cekura ne FDT.

Përgjigja për piken e dytë për certifikatën OHSAS 18001 ju kemi ngarkuar nga prodhuesi Viessmann e cila ka afatë deri me datë 27.09.2020 e cila e plotëson kushtin sepse ka afat pas njoftimit për kontratë i cili njoftim është 24.09.2020 dhe pas kërkese nga ana juaj ne ju kemi drejtuar Distributorit për Kosove si është "TERMOVENT" Sh.p.k për certifikatën e re dhe ai na ka dërguar e-mailin e komunikimit me prodhuesin siç kane deklaruar se jem ne proces te vazhdimit te certifikatës dhe ne momentin e marrjes se certifikatës se re do ju a sjellim. Distributori i autorizuar prej Viessmaim për Kosovë e posedon certifikatën ISO 45001:2008 me validitet deri me 24.06.2022 dhe dokumentin qe e autorizohet nga prodhuesi për shitjen, instalimin dhe servisimi.(Gjeni te bashkangjitura dëshmin).

AK-së nuk e ka pranuar këtë çertifikate, kurse e ka pranuar çerftifikaten e ISO 45001 NNSH EGO-ELSA i cili nuk është distributor për shitjen e pajisjeve te makinerisë, sepse ne dosjen e tenderit është nga prodhuesi.

AK-së nuk a e ka definuar çertifikaten OHSAS 18001 a e kërkon për pajisje te makinerisë apo për pajisje medicinale, sepse te ne kane kërkuar sqarim siç shifen me lartë për pajisje te makineris kurse te GOE i propozuar për kontratë e kanë pranuar çertifikaten e ISO 45001 e cila nuk është nga prodhuesi as i pajisjeve te makinerisë e as i pajisjeve medicinale po i kompanisë NNSH EGO-ELSA.

Përgjigja për piken e tretë për certifikaten EN 1504-2 ne nuk e kemi prezantuar për arsye se ky standard

ka të bëjë me perforcim te betonit dhe nuk lidhet me epoxit dhe ne paramas nuk kemi pozicion për përmirësimin e betonit, mirëpo pasi ju keni kërkuar dhe është dokument që ekziston me datë me herët para njoftimit për kontratë sipas nenit 72 ne ju kemi ngarkuar ne e-prokurim ne pjesën dorëzim ne AK-së me datë 14.10.2020 ne ora 14:28 me tekst te fajlit" Certifikata.rar" e cila i plotëson te gjitha si janë te cekura ne FDT.

Eksperti Shqyrtues sqaron, se AK sipas LPP-së dhe Rruopp-së ka kërkuar informata sqaruese:

Mungon licenca	Mund te kërkohen informata sqaruese	66
Mungon certifikata ISO	Mund te kërkohen informata sqaruese	69

Ku OE ankuesi ju ka përgjigjur, duke ia bashkangjitur të gjitha dokumentet e kërkuara dhe po ashtu edhe dëshmi shtesë lidhur me Certifikatat ISO.

Andaj AK është dashur që ti verifikoj me kujdesë dhe të vërtetoj mirëqenien e tyre, dhe se ky pretendim i OE ankuesit qëndron i bazuar.

Pretendimet e OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit:

GOE i propozuar për kontratë nuk i posedon këto dokumente te cekura me poshtë:

1.Pretendimi i OE ankusit kundër OE të rekomanduarit: Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM nuk e permban emrin e tenderit as numrin e prokurimit te dy operatorve.

Eksperti Shqyrtues gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit sqaron se: Në ofertën e OE të rekomanduarit Deklaratat janë të nënshkruara por nuk e përmbajnë titullin e Aktivitetit të prokurimit dhe po ashtu numrin e prokurimit, andaj ky pretendim **gjendet pjesërishtë i bazuar**, me faktin se AK në dosjen e tenderit nuk e ka vendosur titullin dhe nr e Aktivitetit të Prokurimit, pra është devijim i AK-së shih më poshtë:


Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

[illegible]	
[illegible]	
[illegible]	
[illegible]	
[illegible]	
[illegible]	

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Deklarate se shkruar nën Betim	**Evidenca 1 Një deklarata e shkruar nën Betim,e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2**

2. Pretendimi i OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit:

(2.2 Dokumentet e firmës Sh.P.K. AR-TECH) nuk e ka te vazhdume ne ARBK po e ka ngarkuar te vjetrën.

Eksperti Shqyrtues gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit sqaron se: Në ofertën e OE të rekomanduarit, anëtari i konzorciumit SHPK AR-TECH, ka bashkangjitur Certifikatën e biznesit të vjetrën, mirëpo konform LPP_së dhe Rruopp-së AK ka mundur të kërkojë informatat sqaruese, andaj ky pretendim **gjendet pjesërisht i bazuar**.

Mungon Certifikata e regjistrimit te biznesit	Mund te kërkohen informata sqaruese	66
Mungon Certifikata e TVSH	Mund te kërkohen informata sqaruese	66

3. Pretendimi i OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit:

(2.1 Dokumentet e firmes N.N.SH. EGO-ELSA) ne informata mbi biznesin, te ngarkume e ka aktivitetin primarë "Agjencitë e patundshmërive" dhe kërkun nuk e ka ne aktivitet "Zhvillimi i projekteve të ndërtimit", prandaj projekti ka te bejë me renovim dhe ndertim e jo me shitje.

Eksperti Shqyrtues gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit sqaron se në Certifikatën e biznesit të grupit të operatorëve në konzorcium, aktivitet primarë NNSH Ego Elsa e ka "Agjencitë e patundshmërive" dhe AR-Tech aktivitet primarë e ka "Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore" ndërsa aktivitet sekondarë kanë disa lloje ë aktiviteteve që përkojnë me Aktivitetin e prokurimit, ku AK në DT nuk e ka të cekur decidivishtë aktivitetin biznesor që të jetë "Zhvillimi i projekteve të ndërtimit", andaj ky pretendim **gjendet pjesërisht i bazuar.**

4. Pretendimi i OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit:

(4.1 Lista e kontratave AR-TECH)-tek lista e ngarkuar nuk është e vulosur siç kërkohet me ligj edhe ne projektet e prezantuar shihet se nuk ka te bëjë me punë te ngjashme siç kërkohet ne FDT.

Eksperti Shqyrtues gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit sqaron se tek Lista e kontratave nuk është e nënshkruar dhe e vulosur, mirëpo AK në DT nuk ka të cekur se është e nevojshme të nënshkruhet dhe të vuloset. Ndërsa sa i përket natyrës së kontratave të

ngjashme

Në brendi të referencave/kontratave tek specifikimet teknike/punët e kryera, natyra e punëve të kryera është e ngjashme. Andaj mbetet në diskrecion të AK-së që ti vlerësoj dhe analizoj këto kontrata.

5. Pretendimi i OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit:

Kërkesa ne FDT-2 Inxh.i dipl. i Arkitekturës-Ndërtimit 5 vjet përvojë pune pas diplomimit ka bashkangjitur inxh e arkitekturës Besmir Ajetin i cili ka diplomuar me datë: 20mars 2019 i cili nuk e plotëson kushtin e FDT-së.

Eksperti Shqyrtues gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit sqaron se në ofertën e OE të rekomanduarit tek Inxhinieri i Arkitekturës Besmir Ajeti shihet se i njejti ka diplomuar më 20.03.2019 dhe po ashtu punon tek OE prej 04.10.2016, pra nuk ka përvojë 5 vjeçare(shih mëposhtëm) gjë që nuk i plotëson kriteret e FDT-së. **Pretendimi i OE ankuesit gjendet i bazuar.**

Curriculum vitae

Besmir Ajeti

Viti, Kosovë
Mob:048-931-478
Vendbanimi:Viti
Gjinia: Mashkull
Data e lindjes:11.03.1995

KUALIFIKIMI PROFESIONAL

Shkollimi I larte:

Universiteti I Prishtines "Hasan Prishtina"-Fakulteti i Ndertimtarise dhe Arkitektures, Departmenti :Arkitekture

PËRVOJA E PUNËS

Inxhinier I arkitektures ne NNSH "Ego-Elsa" Prishtine nga 04.10.2016

AFTËSITË

Aftësitë në kompjuter: Aftësi të shkëlqyera për të përdorur Programet e Microsoft Office
Aftësi të shkëlqyera për të përdorur shumë aplikacione në internet
Aftësi për tu adaptuar në ambiente dhe kultura të ndryshme pune
Aftësi të mira të komunikimit
Aftësi për të drejtuar

Gjuhët:

Shqip (gjuhë amtare), Anglisht (mesatare) ,Serbe (mesatare)

Patent Shoferi: Kategoria B

6. Pretendimi i OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit:

Kërkesa ne FDT- Inxh.i dipl. i Makinerisë- termoenergjetikës 5 vjet përvojë pune pas diplomimit ka bashkangjitur inxh e arkitekturës Faton Behrami i cili ka diplomuar me datë 12 mars 2020 i cili nuk e plotëson kushtin e FDT-së.

Eksperti Shqyrtues gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit sqaron se në ofertën e OE të rekomanduarit tek Inxhinieri i Makinerisë Faton Behrami shihet se i njëjti ka diplomuar më 12.03.2018, gjë që nuk i plotëson kriteret, shih mposhtë kriterin e AK-së në DT si dhe CV-në e Inxhinierit të makinerisë.

Kerkesa 5- Operatori ekonomik duhet te angazhoi personel profesional 1 ing I ndertimtarise drejtimi konstruktiv me pervoje pune min 5 vjet pas diplomimit. 2 Inxh.i dipl. i Arkitektures- Ndertimit 5 vjetë përvojë pune pas diplomimit; 3. Inxh.i dipl. i Makinerisë- termoenergjetikës 5 vjetë përvojë pune pas diplomimit; 4. Inxhinier i elektroteknikës- 5 vjetë përvojë pune pas diplomimit;	**Evidenca 5 CV, kontrata e punës me pëndhënsinë për këtë projekt ose marveshje për angazhimin për pikën 1,2,3dhe 4**

Curriculum vitae

Faton Behrami

Mitrovicë, Kosovë
Mob:045-486-165
Vendbanimi: **Mitrovicë**
Gjinia: Mashkull
Data e lindjes:16.08.1980

KUALIFIKIMI PROFESIONAL

Shkollimi i larte:

Universiteti I Prishtines "Hasan Prishtina"-Fakulteti i Inxhinierise Mekanike-Termoenergjetike dhe Termoteknike

PËRVOJA E PUNËS

Inxhinier I makinerise ne NNSH "Ego-Elsa" Prishtine nga 11.07.2015

AFTËSITË

Aftësitë në kompjuter: Aftësi të shkëlqyera për të përdorur Programet e Microsoft Office
Aftësi të shkëlqyera për të përdorur shumë aplikacione në Internet
Aftësi për tu adaptuar në ambiente dhe kultura të ndryshme pune
Aftësi të mira të komunikimit
Aftësi për të drejtuar

Gjuhët:

Shqip (gjuhë amtare), Anglisht (mesatare) ,Serbe (mesatare)

Patent Shoferi: Kategoria B

7. Pretendimi i OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit:

Kërkesa ne FDT- Certifikatat e prodhuesit për pozicionet e Klimatizimit dhe ventilimit dhe sisteme medicinale dhe atë ENISO 9001, EN ISO 13485, EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 EEC dhe OHSAS18001, ka bashkangjitur certfikaten ISO 45001 NNSH EGO-ELSA e kompanisë e cila nuk i plotëson

kushtin e FDT-së sepse është kërkuar nga prodhuesi e NNSH EGO-ELSA nuk prodhon Termopompa e as klimakomora siç kërkohet ne paramase .

Prandaj te gjitha pikat e cekura nuk i plotëson siç kërkohet ne Njoftimin per kontrate dhe ne FDT.

Eksperti Shqyrtues gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit sqaron se kërkesa e AK-së në FDT ka qenë:

Kerkesa 3- Operatori Ekonomik duhet t'i sjellë certifikatat e prodhuesit për pozicionet e Klimatizimit dhe ventilimit dhe sisteme medicinale dhe atë certifikatat EN ISO 9001, EN ISO 13485, EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 EEC dhe OHSAS18001	**evidenca 3- certifikatat e prodhuesit për pozicionet e Klimatizimit dhe ventilimit dhe sisteme medicinale dhe atë certifikatat EN ISO 9001, EN ISO 13485, EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 EEC dhe OHSAS18001**

OE i rekomanduar në ofertën e tij ka bashkangjitur certifikatat në emër të biznesit, ndërsa është kërkuar citat "Operatori Ekonomik **duhet t'i sjellë certifikatat e prodhuesit** ".

Andaj pretendimi i OE ankuesit gjendet i bazuar.

Zertifikat

Certificate

Occupational Health and Safety Management system

Certificate No.: 1010EURO

For: N.N.Sh. Ego-Elsa

Address: K.e Diellit Rifat Burbuvë 1 H.2 nr.2, Prishtinë

Assessment Scope: Installation of air conditioning, oxygen, compressor systems, servicing and maintenance and work with asbestos treatment

International Standard: ISO 45001:2018, Occupational Health and Safety Management System

Issue: 01, Certification date: 04 May 2020
Date of issue of the certificate: 04.05.2020
Date of validity of the certificate: 03.05.2021

Assessment Project: This assessment project for certificate is realized by EBSGMBH based on project contract: 15.04.2020
Validity remains subject to satisfactory annual surveillance audit.
The certificate will be extended for one year.
Recertification audit before date of first issuance

Certificate owner's: Online: www.ebsgmbh.com/QMTUV/1010O
Offices: EBS © Qualitätsmanagement Technische Inspektion
Und Validierung,Kriterbachweg 1, D-60325 Frankfurt am Main, Germany
Email: validity@ebsgmbh.com

OHSAS ISO 45001:2018

Zertifikat

Certificate

Environmental Management system

Certificate No: 1010ERE

For: **N.N.Sh. Ego-Elsa**

Address: K.e Dielli Rifai Burdhevq I H 2 nr 2, Prishtinë

Assessment Scope: Installation of air conditioning, oxygen, compressor systems, servicing and maintenance and work with asbestos treatment

International Standard: ISO 14001:2015, Environmental Management System

Issue: 01, Certification date: 04 May 2020
Date of issue of the certificate: 04.05.2020
Date of validity of the certificate: 03.05.2021

Assessment Project: This assessment project for certificate is realized by EBS GMBH based on project contract: 15.04.2020.
Validity remains subject to satisfactory annual surveillance audit.
The certificate will be extended for one year.
Recertification audit before date of first issuance

Certificate search: Online: www.ebsgmbh.com/QMTUV/1010E
Offices: EBS # Qualitätsmanagement Technische Inspektion
Und Validierung,Kettenhofweg 1, D-60325 Frankfurt am Main, Germany
Email: validity@ebsgmbh.com

Exzellente Bewertungssystem

EMS ISO 14001:2015

Authorized Signature

Zertifikat

Certificate

Quality Management system

Certificate No: 1010ERQ

For: **N.N.Sh. Ego-Elsa**

Address: K.e Dëllëi Rifat Burxhevaj 1 H.2 nr.2, Prishtinë

Assessment Scope: Installation of air conditioning, oxygen, compressor systems, servicing and maintenance and work with asbestos treatment

International Standard: ISO 9001:2015, Quality Management System

Issue: 01, Certification date: 04 May 2020
Date of issue of the certificate: 04.05.2020
Date of validity of the certificate: 03.05.2021

Assessment Project: This assessment project for certificate is realized by EBSGMBH based on project/contract: 15.04.2020.
Validity remains subject to satisfactory annual surveillance audit.
The certificate will be extended for one year.
Recertification audit before date of first issuance

Certificate search: Online: www.ebsgmbh.com/QMTUV/1010Q
Offices: EBS # Qualitätsmanagement Technische Inspektion
Und Validierung,Kettenhofweg 1, D-60325 Frankfurt am Main, Germany
Email: validity@ebsgmbh.com

Exzellente Bewertungssystem

QMS ISO 9001:2015

Authorised Signature

Eksperti Shqyrtues si konkludim sqaron, pretendimet e OE ankues janë pjesërisht të bazuara, andaj aktiviteti i prokurimit mendoj se duhet të kthehet në rivlerësim me qëllim që AK të bëjë vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave konform LPP-së dhe Rruopp-së, meqë disa nga pretendimet e OE ankuesit janë të bazuara dhe të faktuara. Eksperti Shqyrtues tutje rekomandon AK-në që pretendimet e lartë sqaruara, gjatë procesit të rivlerësimit ti rishikoj me kujdesë siq janë: Certifikatat ISO, Listat e kontratave të ngjajshme, si dhe kriteret e tjera të kërkuara sipas FDT-së, me qëllim që ky aktivitet i prokurimit të përmbyllet konform LPP-së dhe Rruopp-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht, vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe se lënda të kthehet në **Rivlerësim.**

Autoriteti Kontraktues, me datë: 06.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **Nuk Pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 09.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **Pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Pasi kemi pranuar email me date: 06.11.2020, ore 11;27 nga OSHP-ja ku ne email është bashkangjitur raporti i ekspertit me numër 867/20 dhe është kërkuar te japim një përgjigje për ketë raport se pajtohemi apo nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit.

Ne pajtohemi me mendimin e ekspertit për arsye se ka dëshmuar se ka bere ekspertize t drejt ne lidhje me pretendimet tona ankimore. Vetëm se eksperti është dashur te propozon te paneli shqyrtues i OSHP-së ne si OE si o plotsojm te gjitha kushtet baze te njoftimit për kontratë dhe ne baze te FDT-së dhe jo te kërkoj qe te kthehet ne rivlerësim.

Prandaj kerkojm nga paneli shqyrtues i OSHP-së te nxjerr vendim te qarte ku ne te shpallemi fitues si OE me çmime me te ulet dhe ta hedh poshtë propozimin e ekspertit për rivlerësim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "AC ing" Sh.p.k- Prishtinë, fillimisht AK gjatë vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarim nga OE ankues sipas letrës standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit duke kërkuar sqarim lidhur me kërkesat e FDT-së: Kërkesa e AK-së: Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim. Kriteri ka qenë: 1. EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 EEC dhe OHSAS18001 & EN 1504-2; 1. Sqarimi -Te sjellet deshmia për EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 EEC; te ne është prezentuar vetëm shenja CE 93 42 EEC. Sqarimi -Te sjellet deshmia OHSAS18001 me validitet; te ne ne sistem me datë validiteti është vetëm deri me 27.09.2020. 3. Sqarimi -Te sjellet deshmia EN 1504-2: te ne nuk është prezentuar fare. Lidhur me këtë kërkesë të AK-së, OE ankues i është përgjigjur AK-së duke i bashkangjitur dokumente.

AK pasi ka pranuar dokumentet e prezantuara ka marr vendimin dhe ka eliminuar OE ankuesin me arsyetimin:

Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Prishtinë

" AC ing " SH.P.K.. Qendra Tregtare Bregu i Diellit, Lok.Nr.47. -. PRISHTINË

Nr i Prokurimit	**701-20-5713-5-2-1**
Nr i brendshëm	**701-20-274-521**

Titulli: Adaptimi i hapsirës për ANGIOGRAF në klinikën e Neurologjisë - QKUK.

I/e nderuar(a)
Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit* Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Oferta e juaj nuk e plotson këto kritere:

Komisioni konstaton se Operatori ekonomik **" AC ing " SH.P.K.. Qendra Tregtare Bregu i Diellit, Lok.Nr.47. -. PRISHTINË** nuk e ka përbushur kriterin :

1. **Nuk ka ofruar nuk ka ofruar certifikatat EN ISO 14971, OHSAS18001 dhe EN1504-2; edhe mbas kerkesës për sqarime nuk e ka plotsuar kët kritere – ka ofruar çertifikata qe nuk perkojnë me dokumentacionin e prodhuesit fillestar qe jan derzuar ne E Prokurimi.**
2. **OHSAS18001- jo me validitet**

Përgjigjja për pikën e parë për certifikatën EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 ECC- ju kemi ngarkuar në e-prokurimi në pjesë dorëzim në AK-së me datë 15.10.2020 në ora 14:57 me tekst të fajlit"100-MD103-022-1501-100-0_GMS.pdf " e cila i plotëson te gjitha si janë të cekura në FDT.

Përgjigja për pikën e dytë për certifikatën OHSAS 18001 ju kemi ngarkuar nga prodhuesi Viessmann e cila ka afat deri me datë 27.09.2020 e cila e plotëson kushtin sepse ka afat pas njoftimit për kontratë i cili njoftim është 24.09.2020 dhe pas kërkesës nga ana juaj ne ju kemi drejtuar Distributorit për Kosovë si është "TERMOVENT" Sh.p.k për certifikatën e re dhe ai na ka dërguar e-mailin e komunikimit me prodhuesin siç kanë deklaruar se jem në proces të vazhdimit të certifikatës dhe në momentin e marrjes së certifikatës së re do ju a sjellim. Distributori i autorizuar prej Viessmaim për Kosovë e posedon certifikatën ISO 45001:2008 me validitet deri me 24.06.2022 dhe dokumentin që autorizohet nga prodhuesi për shitjen, instalimin dhe servisimin.(Gjeni te bashkangjitura dëshmin).

AK-së nuk e ka pranuar këtë certifikatë, kurse e ka pranuar cerftifikatën e ISO 45001 NNSH EGO-ELSA i cili nuk është distributor për shitjen e pajisjeve të makinerisë sepse në dosjen e tenderit është nga prodhuesi.

AK-së nuk a e ka definuar certifikatën OHSAS 18001 a e kërkon për pajisje të makinerisë apo për pajisje medicinale sepse tek ne kanë kërkuar sqarim siç shihen më lartë për pajisje të makinerisë kurse te GOE i propozuar për kontratë e kanë pranuar certifikatën e ISO 45001 e cila nuk është nga prodhuesi as i pajisjeve të makinerisë e as i pajisjeve medicinale po i kompanisë NNSH EGO-ELSA.

Përgjigja për pikën e tretë për certifikatën EN 1504-2 ne nuk e kemi prezantuar për arsye se ky standard ka të bëjë me përforcim të betonit dhe nuk lidhet me epoxit dhe në paramasë nuk kemi pozicion për përmirësimin e betonit, mirëpo pasi ju keni kërkuar dhe është dokument që ekziston me datë me herët para njoftimit për

kontratë sipas nenit 72 ne ju kemi ngarkuar në e-prokurim në pjesën dorëzim në AK-së me datë 14.10.2020 ne ora 14:28 me tekst te fajlit" Certifikata.rar" e cila i plotëson të gjitha si janë të cekura në FDT.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK sipas LPP-së dhe Rruopp-së ka kërkuar informata sqaruese:

Mungon licenca	Mund te kërkohen informata sqaruese	66
Mungon certifikata ISO	Mund te kërkohen informata sqaruese	69

Ku OE ankuesi ju ka përgjigjur duke ia bashkangjitur të gjitha dokumentet e kërkuara dhe po ashtu edhe dëshmi shtesë lidhur me Certifikatat ISO. Andaj, AK është dashur që ti verifikoj me kujdes dhe të vërtetoj mirëqenien e tyre, dhe se ky pretendim i OE ankuesit qëndron i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "AC ing" Sh.p.k- Prishtinë, se OE i rekomanduar nuk posedon Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM, nuk e përmban emrin e tenderit as numrin e prokurimit të dy operatorëve.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit, sqaron se në ofertën e OE të rekomanduarit janë të nënshkruara deklaratat nën betim por nuk e përmbajnë titullin e aktivitetit të prokurimit dhe po ashtu numrin e prokurimit. Andaj, ky pretendim është pjesërrisht i bazuar me faktin se AK në dosjen e tenderit nuk e ka vendosur titullin dhe numrin e aktivitetit të prokurimit, pra është devijim i AK-së, si më poshtë:

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
Kontaktoni me:	
Emri:	
Mbiemri:	
Datëlindja:	
Vendlindja:	

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Deklarate se shkruar nën Betim	**Evidenca 1 Një deklarata e shkruar nën Betim,e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2**

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues "AC ing" Sh.p.k- Prishtinë, se OE i rekomanduar (2.2 Dokumentet e firmës Sh.P.K. AR-TECH) nuk e ka të vazhduar në ARBK po e ka ngarkuar të vjetrën.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit sqaron se në ofertën e OE të rekomanduarit, anëtari i konzorciumit SHPK AR-TECH, ka bashkangjitur certifikatën e biznesit të vjetrën, mirëpo konform LPP-së dhe Rruopp-së, AK ka mundur të kërkojë informatat sqaruese, andaj ky pretendim gjendet pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "AC ing" Sh.p.k- Prishtinë, se OE i rekomanduar (2.1 Dokumentet e firmes N.N.SH. EGO-ELSA) në informata mbi biznesin, të ngarkuara e ka aktivitetin primar "Agjencitë e patundshmërive" dhe nuk e ka në aktivitet "Zhvillimi i projekteve të ndërtimit", prandaj projekti ka te bejë me renovim dhe ndertim e jo me shitje.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit sqaron se në certifikatën e biznesit të grupit të operatorëve në konzorcium, aktivitet primarë NNSH Ego Elsa e ka "Agjencitë e patundshmërive" dhe AR-Tech aktivitet primar e ka "Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore" ndërsa aktivitet sekondar kanë disa lloje ë aktiviteteve që përkojnë me Aktivitetin e prokurimit, ku AK në dosje të tenderit nuk e ka të cekur decidivisht aktivitetin biznesor që të jetë "Zhvillimi i projekteve të ndërtimit", andaj ky pretendim gjendet pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "AC ing" Sh.p.k- Prishtinë, se OE i rekomanduar (4.1 Lista e kontratave AR-TECH)-tek lista e ngarkuar nuk është e vulosur siç kërkohet me ligj edhe në projektet e prezantuara shihet se nuk ka të bëjë me punë të ngjashme siç kërkohet në FDT.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit sqaron se tek Lista e kontratave nuk është e nënshkruar dhe e vulosur, mirëpo AK në dosje të tenderit nuk ka të cekur se është e nevojshme të nënshkruhet dhe të vuloset. Ndërsa sa i përket natyrës së kontratave të ngjashme në brendi të referencave/kontratave tek specifikimet teknike/punët e kryera, natyra e punëve të kryera është e ngjashme. Andaj mbetet në diskrecion të AK-së që ti vlerësoj dhe analizoj këto kontrata.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "AC ing" Sh.p.k- Prishtinë, se OE i rekomanduar, tek kërkesa ne FDT-2 Inxh.i dipl. i Arkitekturës-Ndërtimit 5 vjet përvojë pune pas diplomimit ka bashkangjitur inxh e arkitekturës

Besmir Ajetin i cili ka diplomuar me datë: 20mars 2019 i cili nuk e plotëson kushtin e FDT-së.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit sqaron se në ofertën e OE të rekomanduarit tek Inxhinieri i Arkitekturës Besmir Ajeti shihet se i njëjti ka diplomuar më 20.03.2019 dhe po ashtu punon tek OE prej 04.10.2016, pra nuk ka përvojë 5 vjeçare (shih mëposhtëm) gjë që nuk i plotëson kriteret e FDT-së. Pretendimi i OE ankuesit gjendet i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "AC ing" Sh.p.k- Prishtinë, se OE i rekomanduar tek kërkesa në FDT- Inxh.i dipl. i Makinerisë- termoenergjetikës 5 vjet përvojë pune pas diplomimit ka bashkangjitur inxh e arkitekturës Faton Behrami i cili ka diplomuar me datë 12 mars 2020 i cili nuk e plotëson kushtin e FDT-së.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyertues gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit sqaron se në ofertën e OE të rekomanduarit tek Inxhinieri i Makinerisë Faton Behrami shihet se i njëjti ka diplomuar më 12.03.2018, gjë që nuk i plotëson kriteret, ku eksperti ka bashkangjitur kërkesën e shkëputur nga dosja e tenderit dhe CV-në e Inxhinierit të makinerisë. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "AC ing" Sh.p.k- Prishtinë, se OE i rekomanduar tek kërkesa ne FDT- Certifikatat e prodhuesit për pozicionet e Klimatizimit dhe ventilimit dhe sisteme medicinale dhe atë ENISO 9001, EN ISO 13485, EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 EEC dhe OHSAS18001, ka bashkangjitur certfikaten ISO 45001 NNSH EGO-ELSA e kompanisë e cila nuk i plotëson kushtin e FDT-së sepse është kërkuar nga prodhuesi e NNSH EGO-ELSA nuk prodhon Termopompa e as klimakomora siç kërkohet ne paramase. Prandaj të gjitha pikat e cekura nuk i plotëson siç kërkohet në njoftimin për kontratë dhe në FDT.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit sqaron se kërkesa e AK-së në FDT ka qenë:

Kerkesa 3- Operatori Ekonomik duhet t'i sjellë certifikatat e prodhuesit për pozicionet e Klimatizimit dhe ventilimit dhe sisteme medicinale dhe atë certifikatat EN ISO 9001, EN ISO 13485, EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 EEC dhe OHSAS18001	**evidenca 3- certifikatat e prodhuesit për pozicionet e Klimatizimit dhe ventilimit dhe sisteme medicinale dhe atë certifikatat EN ISO 9001, EN ISO 13485, EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 EEC dhe OHSAS18001**

OE i rekomanduar në ofertën e tij ka bashkangjitur certifikatat në emër të biznesit, ndërsa është kërkuar citat "Operatori Ekonomik duhet t'i sjellë certifikatat e prodhuesit ". Andaj pretendimi i OE ankuesit gjendet i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve sipas kritereve të përcaktuara në dosje të tenderit, ku pretendimet e OE ankues janë pjesërisht të bazuara. Andaj, obligohet AK që të bëjë vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave konform nenit 59 të LPP-së dhe dispozitave të RRUOPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK);

1x1 OE "AC ing" Sh.p.k-Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.